



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:058429

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521601

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari Driton Sadiku, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdija, në lëndën penale ndaj të pandehurit M.S., nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK-së), i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.982/2023 të datës 20.02.2024, duke vendosur lidhur me propozimin e prokurorisë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datën 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.982/2023 e datës 20.02.2024,, gjykata në kuptim të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (në vazhdim KPP-së), jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

M.S., nga i ati ... e ëma ...i lindur me datën ... në Gjakovë, me vendbanim në fshatin ... dhe me vendqëndrim në Gjermani, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ESH T Ë F A J T O R

Sepse me datën 30.07.2022, rreth orës 22:40 minuta, në rrugën "... në Gjakovë, i pandehuri me dashje e dëmton pasurinë e të dëmtuarës“ ...”, me pronar V.B., në atë mënyrë që natën kritike i dëmtuari me kërkesë të policisë në cilësinë e kontraktorit të kamionit tërheqës, i vendos bllokatat veturës Mercedes Benz, me targa ..., për parking të parregullt, mirëpo i pandehuri po sa kthehet tek vend-parkimi, me forcë i largon bllokatat duke i dëmtuar të njëjtat dhe largohet me veturën e tij nga vendi, me ç ‘rast të dëmtuarit ka shkaktuar dëm material në shumë prej njëqindetëdhjetë (180.00) euro.

- me këto veprime ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 38, 40 par.1 pika 1.3, 43, 69, 70 dhe 321 par.1 të KPRK-së, si dhe neni 364 të KPP-së, të pandehurit i;

SH Q I P T O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200.00) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të pandehurit dënimin me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20.00) euro.
- III. DETYROHET i pandehuri M.S., që në emër të dëmit të shkaktuar me veprën penale t'i kompensoj të dëmtuarit V.B., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, shumë prej njëqindetëdhjetë (180.00) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- IV. Detyrohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej njëzet (20.00) euro, si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20.00) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.982/2023, të datës 20.02.2024, ndaj të pandehurit M.S., për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, duke i propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, dhe të pandehurit t’i shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: raporti i Policit S.P., i datës 30.07.2022; deklarata e të dëmtuarit Vehbi Berisha, e dhënë në Polici me datë 30.07.2022; deklarata e të pandehurit M.S., e dhënë në Polici me datën 20.07.2023; foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPP-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsoj dënimin kundër tij, po ashtu të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe me këtë dënim të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe të ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 462 par.1 dhe par.2 të KPP-së, me ç’ rast gjykata ka vlerësuar se të dhënat e mbledhur gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale paraqesin bazë të sigurte dhe të mjaftueshme për vendosjen lidhur me kërkesën pasurore juridike, ngase i dëmtuari në deklarimin e tij në polici ka theksuar se dëmi i shkaktuar është njëqindetëdhjetë (180.00) euro, nërsa vetë i pandehuri në deklarimin e tij në polici ka

deklaruar se “jam në gjendje të ia paguaj dëmin të dëmtuarit dhe t’i kërkoj ndjesë pse e kam dëmtuar bllokadën që ishte e vendosur në veturën time”, pra në mes palëve nuk ka qenë kontestuese vlera e dëmit të shkaktuar me vepër penale e po ashtu i akuzuari ka shprehur gatishmëri që këtë dëm ta kompensoj, andaj gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në bazë nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit në bazë të nenit 36 par. 3 nënpar.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:058429, më datën 28.03.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë kundërshtim në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimet të tij, kundërshtimi paraqitet në këtë gjykatë. Nëse nuk ushtrohet kundërshtim brenda afatit të përcaktuar, aktgjykimi do të merr formë të prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.